



Këshilla për kursim



www.evn.mk



Këshilla për kursim

Energjia elektrike është pjesa më e rëndësishme e jetës së përditshme të njerëzve. Me shfrytëzimin e rregullt dhe kursimin e energjisë elektrike krijojmë ardhmëri më të sigurtë për ne dhe për gjeneratat që vijnë. Për këtë arsye vazhdimisht duhet të kemi kujdes dhe të mos e shpenzojmë energjinë elektrike kot.

Me shfrytëzimin racional të energjisë elektrike e vazhdojmë jetëgjatësinë e aparateve elektrike, e me këtë i ulim edhe shpenzimet të cilat do të ishin rezultat i aparateve të vjetëruara dhe të harxhuara

Shfrytëzimi me mençuri i energjisë elektrike është shumë i rëndësishëm, sepse me çdo poç elektrik të kyçur pa nevojë, me çdo minutë të kaluar të televizorit të kyçur, para të cilit nuk ka asnjëri dhe me çdo kilovat/orë të shpenzuar të energjisë elektrike humbim shumë më tepër se sa mund ta paramendojmë.

Për këtë arsye ju përgatisim këshilla të cilat do t'ju ndihmojnë të filloni dhe ta kurseni energjinë elektrike dhe ta bëni botën më të mirë për jetë.

Thjesht më vendosni mua, sistemin muzikor dhe DVD-në në një prizë dhe vetëm me një tërheqje na çkyçni që të gjithave kur të dilni nga dhoma. Në këtë mënyrë mund ta ulni shpenzimin vjetor për më tepër se 150 KWh.



Konsumi mesatar vjetor i një televizioni me ngjyra në gjendje “stand-by” është 73 kWh.

Shpenzimi i energjisë elektrike tek makina për tharje varet nga lagështia e rrobave të cilat i vendosni në të. Për këtë përpiquni gjithmonë të vendosni rroba mirë të kulluara.

Gjatë blerjes së bojlerit elektrik kini kujdes në izolimin e nxehtësisë së aparatit. Me bojlerin në vit mund të kurseni deri 300 kWh energji elektrike.

Fshesat e rrymës me kapacitet më të madh nuk japin edhe rezultate më të mëdha gjatë pastrimit.

Shfrytëzoni aparate energjetike efikase në amvisëri. Gjatë blerjes kini kujdes që ato të janë të shënuara si aparate të klasit A.

Orët elektronike të cilat gjenden në aparatet elektrike të amvisërisë, si për shembull: në shporet, mikrovalë, radio, orë me zile etj. në vit shpenzojnë rreth 17 dhe 35 kWh energji.

Me shfrytëzimin e çezmës njëshe ose çezmës me termostat për ujë të ngrohtë lehtë mund ta kontrolloni temperaturën e ujit dhe në këtë mënyrë kurseni ujë dhe energji elektrike.

Kohë pas kohe shkrijeni frigoriferin me mekanizmin gjysmëautomatik për shkrierje.

Format me ngjyrë të mbylltë të metalit të enëve për gatim e shkurtojnë kohën e gatimit, ndërsa ato të qeramikës e shtyejnë kohën e gatimit.

Asnjëherë mos e lini derën time të hapur. Më ruani dhe më vendosni më larg shporetit dhe aparateve tjera ngrohëse dhe kurseni deri 40% energji elektrike.



Mjafton +6°C në frigorifer dhe -18°C në pjesën me ngrirje të thellë. Për çdo gradë celzius më pak frigoriferi juaj shpenzon 8-10% më tepër energji elektrike.

Mos vendosni prodhime të ngrohta në frigorifer.

Rregullisht shkrijeni frigoriferin. Vetëm 1 cm akull mund të bëjë edhe deri 75% shpenzime më të larta të energjisë elektrike.

Shfrytëzoni enë për gatim të madhësisë e cila i përgjigjet pllakave të shporetit, që të mos ketë humbje të nxehtësisë.

Mbuloni enët e gatimit me kapak që ta zvogëloni kohën e gatimit.

Për ushqimet të cilat përgatiten më gjatë përdorni enë për përgatitje me avull.

Mos e hapni furrën gjatë kohës së përgatitjes nëse nuk ka nevojë.

Sa më e ftohtë të jetë hapësira ku qëndron frigoriferi aq më i vogël është shpenzimi i energjisë elektrike, për këtë arsye planifikoni mirë hapësirën ku do ta vendosni frigoriferin tuaj.

Çkyçeni furrën 10 minuta para se ushqimi të jetë tërësisht gati.

Mos e lini derën e ballkonit të hapur gjatë kur unë punoj. Thjesht, ajroseni dhomën shumë shkurtë me derë ose dritare krejtësisht të hapur, në këtë mënyrë do ta ngrohni dhomën, ndërsa fatura juaj do të mbetet e ftohtë!



Dyert dhe dritaret hapni më shpesh, por shkurt, që të mos humbet nxehtësia e hapësirës e cila ngrohet.

Pastroni filterët e klimatizuesve rregullisht – krahas asaj që është mjaft ekonomike është e mirë edhe për shëndetin.

Fikeni TV marrësin atëherë kur nuk e ndiqni dhe do t'i ulni shpenzimet tuaja vjetore të energjisë elektrike në vetëm 79 kW/h, dhe me këtë do të paguani shumë më pak.

Me sistemin muzikor mund të kurseni edhe deri 73 kW/h në vit nëse nuk e shfrytëzoni obcionin për “stand-by”.

Kompjuteri juaj dhe printeri gjithashtu mund t'ju ndihmojnë në shpenzimet e ulura të energjisë nëse nuk e shfrytëzoni “stand-by” regjimin dhe do të mundeni t'i ulni shpenzimet mesatare vjetore në 110 kW/h.

Dritarja e hapur jo tërësisht paraqet rregullatorë të keq të ajrit. Që të arrihet këmbimi i nevojshëm i ajrit në hapësirën me dritare jo tërësisht të hapur pa nevojë shpenzohet energji për ngrohje.

Shfrytëzoheni lavatriçen vetëm atëherë kur është e mbushur tërësisht, në atë mënyrë nuk shpenzoni energji elektrike më tepër se që nevojitet.

Shfrytëzoheni programën për kursim të energjisë elektrike tek lavatriçja. Robrat pak të fëlliçura do të lahen edhe në 60°C njëlloj si edhe në temperaturë më të lartë.



Më fikni mua dhe poçet tjera kur dilni nga dhoma. Poçet e thjeshta elektrike ndërroni me poçet e reja kursyese, të cilat ulin shpenzimin e energjisë elektrike deri 25 %.

Mos lejoni që 25% të faturës suaj të shkojnë kot në poçet elektrike të ndezura. Fikni dritat kur dilni nga hapësira më gjatë se 10 minuta, në këtë mënyrë do të mund t'i ulni shpenzimet e energjisë së përgjithshme elektrike në shtëpi.

Kyçeni bojlerin vetëm atëherë kur duhet të bëni dush, sepse për ¼ e shpenzimeve të energjisë elektrike është fajtor pikërisht bojleri.


Uleni shpenzimin e ujit, sepse pjesa më e madhe e energjisë shpenzohet për sjelljen e ujit të freskët dhe përçimin e ujit të shfrytëzuar, në këtë mënyrë do të kurseni dhe do të fitoni faturë më të ulët të energjisë elektrike.

Rregulloni vendet ku rrjedh uji nga bojleri juaj, sepse çdo pikë e ujit është pjesë e faturës suaj.

Mbushësi i celularit shpenzon energji elektrike madje edhe atëherë kur nuk është i lidhur me celularin tuaj. Për këtë arsye fikeni dhe filloni të kurseni.

Distribuimin e ndriçimit në shtëpinë tuaj bëjeni në mënyrën më produktive të mundshme. Krijoni radhitje të mirë se si do e ndriçoni shtëpinë tuaj.

Shfrytëzoni poçe kursyese për hapësirat të cilat i ndriçoni gjatë kohë. Një poç kursyes me fuqi prej 20 W jep sasi të njëjtë të dritës si edhe poçi i thjeshtë me fuqi prej 100 W.



Numri për informata: **0890 12345**

Numri për difekte: **0890 88888**

E-posta: **info@evn.mk**

Web-faqja: **www.evn.mk**

EVN Macedonia SHA

Qendra për marëdhënie me konsumatorët

11 Tetori nr. 9

1000 Shkup, R. e Maqedonisë